



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA  
KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
*Qeveria-Vlada-Government*



**KËSHILLI KOMBËTAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK TË KOSOVËS**  
**SEKRETARIATI**

**Përmbjedhje nga takimi i parë virtual i Grupit Koordinues  
për trajtimin dhe adresimin e çështjeve ekonomike dhe problemeve që ka  
sektori privat, si rezultat i përballjes me pandeminë COVID-19**

**Prishtinë, 5 maj 2020**  
Takim virtual  
Prishtinë

Mbështetur nga:





**Takimi i parë virtual i Grupit Koordinues  
për trajtimin dhe adresimin e çështjeve ekonomike dhe problemeve që ka  
sektori privat, si rezultat i përballjes me pandeminë COVID-19**

E martë, 5 maj 2020, ora **16:00 – 18:00**

Prishtinë

## **Agjenda**

- 16:00 – 16:15 Fjala Hyrëse  
Znj. **Rozeta Hajdari** - Kryesuese e Grupit Koordinues, Ministre e Ekonomisë,  
Punësimi, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
- 16:15 – 16:45 Diskutime nga përfaqësuesit e sektorit privat  
Z. **Berat Rukiqi** – Kryetar, Oda Ekonomike e Kosovës
- Likuiditeti i kompanive
  - Lehtësirat fiskale për periudhën në vijim
- Z. **Arian Zeka** – Drejtor Ekzekutiv, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
- Zgjidhja ligjore e detyrimeve të akumulara tatimore të bizneseve gjatë muajve të pandemisë COVID19
  - Vazhdimi i punës së gjykatave komerciale me qëllim të zgjidhjes së lëndëve të natyrës fiskale dhe komerciale
- Znj. **Linda Shala** – Kryetare e Bordit, Dhoma Ekonomike e Grave, G7
- Trajtim i veçantë për bizneset e grave në pakon e rimëkëmbjes ekonomike
- Z. **Skender Krasniqi** – Kryesues i Bordit, Oda e Afarizmit të Kosovës
- Diskutim për përkrahje të prodhuesve me lehtësira për rritje të prodhimit
  - Diskutim i mundësive për kredi urgjente për biznese.
- Znj. **Nora Hasani** – Drejtoreshë Menaxhuese, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare
- Pako mbështetëse për eksportuesit
  - Skemë të granteve/kredive për digjitalizimin e bizneseve
- 16:45 – 17:00 Prezantim i hapave të mëtejme për pakon e rimëkëmbjes  
Z. **Besnik Bislimi** - Ministria e Financave dhe Transfereve
- 17:00 - 17:15 Diskutim i fazave të hapjes së ekonomisë  
Z. **Arben Vitia** - Ministria e Shëndetësisë

17:15 – 17:30 Konkludimet dhe përmbyllja e takimit  
Znj. **Rozeta Hajdari** - Kryesuese e Grupit Koordinues, Ministre e Ekonomisë, Punësimit,  
Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike

**KËSHILLI KOMBËTAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK TË KOSOVËS**  
Sekretariati i KKZHE-së

**TABELA E PJESËMARRËSVE**

Rozeta Hajdari	Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike	Prezent
Ilir Aliu	Ministria e Financave dhe Transfereve	Prezent
Besian Mustafa	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Prezent
Arton Retkoceri	Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit	Prezent
Korab Kamberi	Ministria e Shëndetësisë	Prezent
Xhelal Sveçla	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	Mungon
Emilia Rexhepi	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Prezent
Ilir Murtezaj	Administrata Tatimore e Kosovës	Prezent
Ibrahim Xhaka	Dogana e Kosovës	Prezent
Berat Rukiqi	Oda Ekonomike e Kosovës	Prezent
Arian Zeka	Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë	Prezent
Skender Krasniqi	Oda e Afarizmit të Kosovës	Prezent
Astrit Panxha	Klubi i Prodhuesve të Kosovës	Prezent
Nora Hasani	Oda Ekonomike Gjermane në Kosovë	Prezent
Linda Shala	Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës - G7	Prezent
Lumnije Ajdini	Aleanca Kosovare e Bizneseve	Prezent
Yllka Metaj	Rrjeti i Shitësve me Pakicë	Prezent
Jusuf Azemi	Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat	Mungon
Edison Jakurti	MEPTINIS	Prezent
Naim Huruglica	MEPTINIS	Prezent
Lindita Daija	Sekretariati i KKZHE-së	Prezent
Gent Nushi	Sekretariati i KKZHE-së	Prezent
Dita Dobranja	Sekretariati i KKZHE-së	Prezent
Fjolla Metaj Gashi	Sekretariati i KKZHE-së	Prezent

## SHËNIMET KYQE NGA TAKIMI

**Rozeta Hajdari, Ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjik** ju rikujtoi të pranishmëve se ky Grup Koordinues u themelua gjatë takimit të 11-të të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE). Ajo mes tjerave theksoi që:

- Qeveria dhe MEPTINIS kanë shqyrtuar me kujdes të gjitha kërkesat e parashtruara nga odat të cilat kanë dëgjuar shkresa dhe kanë ndihmuar që të kuptohen më shumë brengat dhe pyetjet e drejtuara, të cilat Ministria Hajdari i ka shpalosur edhe me Ministrin e Shëndetësisë dhe ministrat e tjerë.

Matricën e dërguar në ditën që u mbajt takimi, ajo tha se shumë nga ato përgjigje veçse janë adresuar dhe tashmë një gjë e tillë është e ditur edhe në bazë të masave të marra në praktikë. Disa prej tyre i përmendi shkurtimisht:

- Është lejuar puna pa ndërprerje për pothuajse të gjitha ndërmarrjet. Për ato që nuk kanë punuar i është mundësuar sigurimi i objektit, pra është lejuar lëvizja e stafit të sigurimit dhe depoistëve.
- Për ato kompani të cilat kanë pasur kontrata për eksport, edhe nëse në bazë të NACE kodeve veprimtaria e tyre nuk është lejuar të operoj, atyre u është mundësuar qarkullimi dhe veprimi me leje të veçanta.
- Dogana e Kosovës është kujdesur që Korridori i Gjelbërt të funksionoj rrjedhshëm.
- Është lejuar fillimi i punës për sektorin e ndërtimitarisë nga data 4 maj, 2020.
- Nga 4 maj, 2020 po ashtu janë lejuar një pjesë e konsiderueshme e veprimtarive të fillojnë operimin.
- Shumicës së veprimtarive të tregtisë me pakice, u është lejuar të fillojnë punën. Një numër të vogël të tyre (tezgat), pritet që të hapen në valën, varësisht se si rrjedh situata nga pandemia.

Ministraj Hajdari tha se shpreson që në takim të ketë dialog sa më konstruktiv duke u fokusuar vetëm në konceptin ekonomik dhe asgjë tjetër. Me qëllim që ky takim të shërbej si mundësi e mirë për të drejtuar dhe adresuar çështjet ekonomike dhe problemet që ka sektori privat të shkaktuara nga pandemia COVID-19, si dhe kjo të mundësoj që të ketë inpute me vlerë të cilat do të ndihmojnë në dizajnimin dhe elaborimin e Pakos së Rimëkëmbjes.

Ministria Hajdari i siguroi palët prezente në takim të këtij grupi se ngjashëm do të vazhdojnë edhe më tutje.

**Berat Rukiqi, Kryetar në Odën Ekonomike të Kosovës (OEK)** shpalosi shqetësimet e OEK që ishin:

- Vizitat e shpeshta të inspektorëve tek bizneset, ku ka raste deri në 5 vizita në ditë tek i njejtë biznes. Një kontroll e tillë që do të duhet të ishte më e fokusuar tek qytetarët si konsumator dhe si shkelës më të shpeshtë dhe në masë më të madhe të kufizimeve dhe rregullave të paraqitura si pasojë e pandemisë. Asnjë nga bizneset nuk kanë qenë vatër e përhapjes së virusit deri më tani.
- Shqyrtimi i mundësisë së hapjes së qendrave të hapura tregtare.

Në lidhje me dy pikat e listuara në agjendë, që ishin e para likuiditeti i kompanive dhe e dyta lehtësirat fiskale për periudhën në vijim z. Rukiqi elaboroi se:

- Bizneset formalisht mund të fillojnë punën në datat e caktuara sipas valëve të hapjes, mirëpo praktikisht një gjë e tillë është pothuajse e pamundur meqë secila ballafaqohet me problemin e likuiditetit, në kushtet kur kredidhënia ka stagnim. U propozua alternativë dhe të veprohet shpejtë në këtë drejtim, ku mundësohen kredi afatshkurtër për 3-12 muaj. Shembull specifik mori veprimtaritë e gastronomisë si një sektor i cili është shumë i prekur në këtë aspekt.
- Kërkesë për Zëvendësministrin e Financave në lidhje me Grupin për Rimëkëmbje ekonomike të formuar nga MFT, ku u kërkua që të ketë një përfaqësim adekuat dhe që pjesë të saj nga ana e asociacioneve të biznesit të përfshihet dhe OEK, e cila ndërthen pothuajse të gjithë sektorët që

preken drejtëpërdrejtë nga këto masa si pasojë e pandemisë. Në këtë pikë u kërkua edhe pajtueshmëri dhe mendimi i kolegëve nga odat e tjera.

**Arian Zeka, Drejtor Ekzekutiv, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK)** paraqiti tri pika të propozuara nga OEAK:

- Aprovimi i Projektligjit për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike, ku një pjesë e legjislacionit vetëm është e aprovuar nga qeveria paraprake mirëpo e cila ka mbetur pa u proceduar më tutje në Kuvendin e Republikës së Kosovës për aprovim përfundimtar, tha z. Zeka. Kjo shihet si shumë e rëndësishme për të gjitha bizneset, pra realizimi i transaksioneve në mënyrë elektronike, sidomos në këtë kohë.
- Zgjidhja ligjore e detyrimeve të grumbulluara tatimore të bizneseve gjatë muajve të pandemisë COVID-19, z. Zeka tha se është diskutuar shtyerja në takime të mëhershme dhe është realizuar. Megjithatë, puna voluminoze që do të paraqitet në këto kohë mund të shkaktoj probleme me vonesa si pasojë të ketë edhe ndëshkime pastaj. Prandaj, meqë ATK dhe as Ministria e Financave nuk e kanë diskrecionin e faljeve të një interesi të tillë, OEAK ka propozuar nxjerrjen e një ligji të veçantë që do të mundësonte amnisti për interesin apo gjobën e tyre.
- Vazhdimi i punës së gjykatave komerciale me qëllim të zgjidhjes së lëndëve të natyrës fiskale dhe komerciale. Këtë kërkesë OEAK e bazon në faktin që tashmë ka një numër të madh të lëndëve të cilat presin që të zgjidhen nga ana e gjykatave, dhe tashmë është java e tetë prej kur puna e këtyre institucioneve gjyqësore është pezulluar, e cila do të rezultojë në grumbullimin e mëtejshëm të këtyre lëndëve.

**Linda Shala, Kryetare e Bordit, Dhoma Ekonomike e Grave (G7)** paraqiti një prezantim të shkurtër lidhur me likuiditetin e bizneseve, pagesat e kredive, qirave etj, dhe tha se këto do të jenë sfidat kryesore për bizneset vendore në muajt e ardhshëm.

- Duke pasur parasysh mundësitë financiare që ka Kosova dhe efektshmërinë u propozua që ndihma të realizohet përmes kredidhënies për biznese nga bankat komerciale, mirëpo me garantues shtetin, njëherit të merr përsipër edhe interesin. Këto kredi propozohet të kenë maturitet 2 vjeçar dhe një "grace period" prej 6 muajve.
- Gjithashtu u propozua që Qeveria të mirret me ndryshimin e ligjit të prokurimit dhe së paku për 2 vite të aplikoj faktorin preferencial për kompanitë vendore, për produktet dhe shërbimet e tyre me më së paku 50%. Kjo do të mund të shihet si shkelje e rregullave të MSA-së, por pandemia e arsyeton këtë për ruajtjen e ekonomisë së vendit dhe vendeve të punës, si është shembulli në rastin e Bosnjë-Hercegovinës.
- Digjitalizimi i të gjitha proceseve institucionale brenda Kosovës duke shfrytëzuar shërbimet e sektorit të IT-së në Kosovë. Një përfitim i dy anshëm ku Qeveria do t'iusiguronte punë këtij sektori duke modernizuar dhe lehtësuar proceset mbrenda institucioneve.
- Reagim me politika fiskale, me theks në ndryshimin e Ligjit për TVSH-në, ku importuesit e mallrave do ta paguajnë TVSH-në pas shitjes së mallrave dhe jo me rastin e importit. Një tjetër lehtësi për likuiditetin e kompanive importuese.

Për bizneset më të ndjeshme dhe më të rrezikuara, ato të grave znj. Shala theksoj disa masa.

- Trajtim të veçantë, përveq asaj të mbështetjes së rregullt të biznesve, për ta ruajtur këtë strukturë të vogël e cila sipas statistikave është afër 11%, vlerë kjo duke përfshirë edhe ato biznese që nuk janë aktive. Për këto biznese duhet siguruar grante të drejtëpërdrejta varësisht madhësisë së tyre. Ambienti ekonomik aktual cilësohet si shumë i disfavorshëm për pozitën e këtyre bizneseve. Investimi kundrejt këtyre bizneseve duhet të trajtohet si investim që ka për bazë solidaritetin.
- Sugjerimi i fundit ishte shtyerja (përkrahja) e punës për përmbaruesit derisa biznesi të rikuperohet.

**Rozeta Hajdari, Ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjik** tha se këto janë sugjerime me vend, mirëpo duhet të shihet edhe sipas mundësive që ka buxheti i trashëguar për adresimin e tyre.

**Skender Krasniqi, Kryesues i Bordit, Oda e Afarizmit të Kosovës** dha sqarimet për dy pikat që kishin për diskutim si OAK. E para ishte përkrahja e prodhuesve me lehtësira për rritje të prodhimit dhe e dyta mundësitë për kredi urgjente për biznese.

- Tek përkrahja e prodhuesve me lehtësira për rritje të prodhimit OAK kërkon që prodhuesit, fabrikat dhe bujqësia të lirohen nga të gjitha tatimet dhe taksat për prodhues, përjashtuar TVSH-në duke filluar nga data 1 qershor deri me 31 dhjetor, duke përfshirë tatimin në fitim, tatimin në pagë, tatimin në pronë, tatimin në qira dhe taksat e tjera përcjellëse. Lirimim e plotë të lëndës së parë për prodhuesit, duke respektuar normativat, meqë e njejta lëndë e parë e cila blihet nga jashtë lirohet, ndërsa nëse blihet nga brenda vendit nuk lirohet.
  - Të subvencionohet eksporti prej 10% të shumës së eksportuar, metodë kjo që po përdoret nga shumë vende për të nxitur eksportin, rritjen e prodhimit dhe punësimit.
  - Ka kërkesë që të jepen kredi për bizneset me “grace period” deri në 2 vjet me garantues shtetin deri në 80% të shumës. Apo të jepen kredi nga bankat komerciale dhe interesi të subvencionohet nga shteti. Përfitues të kësaj iniciative të jenë kompanitë prodhuese dhe ato të cilat kanë nevojë për likuiditet.
- Gjithashtu u propozua të krijohet një komision i përbashkët me bizneset dhe qeverinë për të realizuar kërkesën dhe propozojmë që shuma të mos tejkalojë 5 milion Euro.

**Nora Hasani, Drejtoreshë Menaxhuese, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare** para se të prezëntoj dy pikat e OGJEK-së i potencoj dy gjëra.

- Të kërkohej leje për inqizimin e takimit së paku për formalitetet.
- Në lidhje me pyetjen e z. Rukiqi shprehi aprovim për propozimin e tij, për grupin koordinues i cili është themeluar nga Ministri i Financave dhe Transfereve për punën në planin të rimëkëmbjes ekonomike, ku është propozuar një përfaqësues i të gjitha odave dhe tre ekspert të jashtëm. Kërkoj nga të pranishmit nëse janë dakord që të votohet në ato momente të takimit.

**Rozeta Hajdari, Ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike** si moderuese e takimit sqaroi se kishte në plan që t’i dëgjoj të gjithë, pastaj të arrij tek ajo pikë të cilën do ta prezëntoj Zëvendësministri Ilir Aliu. Gjithashtu theksoi se MEPTINIS është koordinuar me Ministrinë e Financave dhe ky grup është jo formal, teknik nga Ministria e Financave që të ftoj akterë tjerë nga fusha e biznesit dhe institucioneve për të marr një pamje sa më të saktë nga inputet e pjesëmarrësve në lidhje me çështjet financiare për rimëkëmbje ekonomike. U sqarua që nuk ka asnjë duplikim me këtë Grup Koordinues që është krijuar brenda KKZHE-së, prandaj në këtë rast nuk është nevoja që të votohet.

**Nora Hasani, Drejtoreshë Menaxhuese, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare** vazhdoi tutje me dy pikat e propozuar për fazën e rimëkëmbjes.

- Pako mbështetëse për eksportuesit. Meqë Kosova si shtet importin e ka 10 herë më shumë se se esportin, u tha se është shumë e nevojshme që të përkrahen ato kompani të cilat eksportojnë. Për OEGJK është shumë e rëndësishme të identifikojmë sektorët të cilët kanë potencial tash dhe ato në të ardhmen, meqë pandemia ka ndikuar në zinxhir të furnizimit në mbarë Evropën duke krijuar mundësi edhe për kompanitë e Kosovës.

- U propozua që në bashkëpunim me Sekretariatën e KKZHE-së, ATK-në, Doganën të identifikohen sektorët, kompanitë dhe bizneset eksportuese, që përmes subvencioneve të përkrahen këto kompani që kanë potencial për me e rrit eksportin.
- Si shumë e rëndësishme u pa edhe përkrahja në standardizim për këto kompani, ku KIESA në të kaluarën ka ofruar grante të ndryshme që kompanitë të pajisen me standarde, që është një dukuri shumë e rëndësishme për eksportuesit e vendit, mirëpo e cila ka një kosto shumë të lartë. Pra posedimi i kompanive që eksportojnë, produkti që plotëson standardin dhe mbete qasja në treg dhe shteti do të duhet ta fuqizoj KIESA-ën dhe të shfrytëzoj rrejtin e odave vendore si dhe rrejtin e bizneseve të diasporës. Në këtë mënyrë të identifikohen partnerë, klient dhe tregje për të rritur eksportin.
- Gjithashtu në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes, OEGJK propozon një lloj sigurimi të kredisë për eksportues sipas modelit të shtetit Gjerman.
- Në temën e dytë u sugjerua të punohet në drejtimin e digjitalizimit dhe për momentin sigurimi i fondeve për një gjë të tillë. si nga bankat komerciale ashtu edhe Fondi për Garanci Kreditore nuk ofron një mundësi të tillë, prandaj u propozua që të mendohet edhe në këtë drejtim.

Për fund kishte pyetje për z. Aliu si:

- Cilat janë planet e MFT-së për fuqizimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore që të jetë funksional, duke e ditur gjendjen politike aktuale? Cilat janë planet e Qeverisë në këtë drejtim?
- A është duke u implementuar pika 10 e Pakos Emergjente?
- Cilat janë prognozatat dhe parashikimet e MFT për periudhën nga muaji shtator e tutje?

**Ilir Aliu, Zëvendësministër i Financave dhe Transfereve** potencoi se pakoja e paraparë nga Qeveria është shumë më e avancuar se kërkesat dhe rekomandimet e parashturara. Pakoja duhet të shpalojë dhe të gjitha sugjerimet që i kanë dhënë sektori privat janë të përfshira në pakon e rimëkëmbjes.

Z. Aliu pyetjeve nga folësit ju përgjigj si mëposhtë:

1. Duke ju përgjigjur z. Berat Rukiqi, MFT tha se nuk ka informata që inspektorët vizitojnë bizneset për të humbur kohën ose pa bazë dhe po ashtu edhe z. Ibrahim Xhaka, mund ta adresojë këtë, duke qenë që të gjitha masat që janë marrë janë të koordinuara në mes të ATK-së, Doganës dhe MFT-së.
2. Për qendrat tregtare, u tha se mendimi i tij dhe i Ministres Hajdari ka qenë që ato sa më shpejt të lirohen, mirëpo duke e pasur parasysh që është prioritet shëndeti i qytetarëve, nuk kanë pasur zgjidhje tjetër përpos të veprohet për atë që e thotë eksperti, që tani nuk është koha për t'i liruar këto biznese.
3. Sa i përket likuiditetit, është e qartë se në shumicën e kompanive mungon likuiditeti dhe se në masat e pakos emergjente kjo çështje është trajtuar. Kjo ndërlidhet edhe me masën 10-të, e cila do të ekzekutohet në ditët në vijim dhe nuk ka ndërlidhje me Parlamentin e Kosovës. Mjetet janë të alokuara dhe e parashih sektorin i cili është goditur më së shumti, hotelerinë dhe restorantet, mikrobizneset dhe bizneset tjera që nuk janë lejuar të punojnë për shkak të pandemisë. Parashihet që ndërmarrjet publike të cilat kanë nevojë për likuiditet, duke i përkrahur pa kusht, pa kamatë, me kusht që deri në fund të vitit t'i kthejnë këto mjete. Në pajtim me BQK-në dhe bankat, mund të thuhet që bankat do të jenë shtylla e zhvillimit ekonomik në planin në të cilin do të paraqitet për rimëkëmbje.
4. Kishte pajtim me propozimet e Z. Arian Zeka nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe mbetet të shihet në mënyrë ligjore si do të procedohen këto propozime.
5. Për bizneset e grave, z. Aliu u pajtua 100% dhe njoftoi që propozimi i MFT është edhe më i avancuar se ajo çka u propozua nga përfaqësuesit e odave. Të gjitha problemet problemet që u adresuan qëndrojnë sipas z. Aliu dhe gratë nuk mund të marrin kredi, se nuk kanë kolateral për



shkak të diskriminimit në trashëgimi. Sidoqoftë, ky është realiteti, për të cilën MFT ka bërë një trajtim të posaçëm për këtë kategori, e cila do të publikohet pasi të sqarohen të gjitha detajet.

6. Në lidhje me propozimin e OAK, për lirimet e bizneseve nga obligimet fiskale, u tha se është gati e pamundur të realizohet në cilindo shtet, mirëpo, si propozim do të merret parasysh dhe do të llogaritet cilat janë benefitet dhe nëse e bankroton shtetin një vendim i tillë. Kujdes i veçantë i është kushtuar kompanive prodhuese dhe kompanive eksportuese, por nuk do të thotë kjo që janë lënë anash industritë tjera, por në mënyrë strategjike, në bashkëpunim me Ministren Hajdari është vendosur që vendi duhet të orientohet drejt prodhimit dhe eksportit. Kjo duke qenë të vetëdijshëm që disbalanci në eksporte dhe importe është shumë i thellë dhe një gjë e tillë i kushton të tërë ekonomisë së vendit.
7. Çështjet e kamatave dhe garancionit, janë përfshirë në pako, ky draft i cili është diskutuar me Qeverinë dhe sugjerimet odave do të merren parasysh. Pra, u tha që kreditë do të garantohen, nuk mund të çeket tani se në çfarë niveli dhe gjithashtu kamatat do të subvencionohen prej shtetit.
8. Kishte pajtueshmëri për prioritzimin e eksportuesve dhe prodhuesve të cekur nga OEGJK dhe me atë që e është thënë se është e rëndësishme të identifikohen sektorët që duhet përkrahur për të vazhduar zhvillimin, por nuk do të thotë të diskriminohen sektorët tjerë, por vetëm duhet të kenë prioritet. Modalitetet se si të bëhet kjo, mbetet të diskutohen. Dakordim pati edhe tek standardizimi dhe certifikimi i produkteve, duke qenë që pa to nuk mund të realizohet eksporti.
9. Në lidhje me pritjet dhe asaj çka mund të ndodhë në shtator, u tha se nuk është në rregull të ketë spekulime. Ende nuk dihet se sa do të zgjas kjo fazë dhe as cili është dëmi i ekonomik. Vlerësimi i humbjeve varion nga 12 milion deri në 18 milion euro në ditë, nga disa burime. Por Zëvendësministri nuk e mendon që humbjet janë aq të mëdha.
10. Për grupin punues për dizajnimin e pakos së rimëkëmbjes, idea e të cilit ka qenë që pjesëmarrës të jenë dy përfaqësues të Odave. Një prej tyre duhet të jetë më i specializuar për çështje të prodhimit, duke qenë që strategjia e shtetit do të orientohet në mbështetje të prodhuesve dhe eksportuesve. Sipas z. Aliu përfaqësuesi i prodhuesve në Kosovë, i cili është nën ombrellën e Odës Ekonomike, duhet të jetë në takim. Mund të ketë rotacion, nëse ka pajtim në mes të Odave. Propozimi nga takimi paraprak ka qenë Z. Arian Zeka, nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Nuk përjashtohet mundësia që të ftohen përfaqësues tjerë të biznesit sipas ekspertizës dhe nevojës. Ky grup punues është profesional për financa, ndërsa strategjia duhet të vijë nga odat.

**Rozeta Hajdari, Ministre e Ekonomisë, Punësimin, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë, dhe Investimeve Strategjike** sqaroi se brenda Grupit Koordinues në kuadër të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, do të marrin orientimet se në cilin drejtim të fokusohet për rimëkëmbjen ekonomike, të cilat i biseduan në takim.

- U vlersua e rëndësishme që MEPTINIS nuk ka trashëguar një njësi që mund të sjellë analiza për industrinë – shembull, industria e Kosovës cilët sektorë i ka me potencial që e çojnë përpara zhvillimin ekonomik në Kosovë. Në këtë aspekt, kjo ministri, bashkë me Qeverinë mund të inicojë një anketë, ndoshta edhe me inputet e odave, por edhe me Agjencinë e Statistikave, për përditësimin e informatave dhe identifikimin e sektorëve prioritar me potencial për zhvillim ekonomik në Kosovë.

Se a do të arrij pako fiskale t'i ndihmojë punëtorët që nuk kanë qenë të regjistruar në ATK dhe nuk kanë kontrata në kompanitë ku punojnë dhe sa në të vërtetë janë të deklaruar nga vet bizneset, Ministrja Hajdari tha se ka dyshime.

**Korab Kamberi, Këshilltar i Ministrit Arben Vitia, Ministria e Shëndetësisë** për planin e hapjes, i cili është bërë publik, për veprimtaritë që do të hapen gradualisht nga faza 1 deri në fazën 3, tha se do të parashihen me rivlerësimin e aktiviteteve të hapjes pas secilës fazë, bazuar në situatën epidemiologjike.

- Posaçërisht për qendrat tregtare vlenë një gjë e tillë, të cilat nuk mund të hapen në fazën e parë, bazuar në rekomandimin e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Me rekomandimin e Ministres Hajdari ishte adresuar kjo për fazën e parë, por ka qenë insistimi i OBSH që kjo të mos mundësohet, duke qenë që është qendër dhe si e tillë, mbetet pikë e kontaktit e të gjithë njerëzve brenda një komuniteti. Ai tha se në këto raste, mjafton një i infektuar t'i infektosh të gjithë që e frekuentojnë atë pikë, e frekuentimi është shumë i lartë, prandaj është vendosur të rishqyrtohet gjatë fazës së dytë.
- Sa i përket inspektorëve në terren, si MSH vlerëson se ka numër të vogël të inspektorëve në terren, dhe numri i tyre duhet të dyfishohet apo trefishohet. Është më se e rëndësishme që gjatë fazës së parë të jenë inspektorët në terren, që të mund të shohin nivelin e zbatimit të masave brenda bizneseve: dezinfektimin e hapësirave të cilat janë leju me u hapë si dhe adoptimin e procedurave dhe standardeve sipas udhëzimeve të dala nga IKSHPK.
- Mosrespektimi i masave në hapësirat e lokaleve, paraqet një tjetër shqetësim për MSH-në. Nga data 4 maj, ka shtim të numrit të qytetarëve, pavarësisht kufizimit që është ende në fuqi. Lokalet që janë hapur nuk e kanë vendosur para hapësirës së hyrjes numrin e klientëve të cilët lejohen brenda hapësirës së njejtë të punës dhe blerjes sipas kufizimit.
- Në përgjigje të z. Berat Rukiqi nga OEK, fakti që bizneset nuk kanë qenë vatra të përhapjes së virusit është si rezultat i faktit që masat e kufizimit janë marrë rreth një javë para së të fillojë rritja eksponenciale e infektimit.

**Rozeta Hajdari, Ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë, dhe Investimeve Strategjike**, tha se duke qenë që qytetarët janë problemi kryesor për qarkullim dhe sjelle të turmave, i është lënë hapsirë vendimit të MSH-së për mbylljen e bizneseve, meqë nuk ka arsyeshmëri ruajtja e ekonomisë kur faktori njeri dëmtohet dhe se resurset njerëzore janë po ashtu qenësore për zhvillim ekonomik.

- Gjithashtu, Ministria Hajdari tregoi mirëkuptim nga z. Berat Rukiqi, mirëpo me hapjen e shumë dyqaneve të tregtisë me pakicë, ekziston frika se sa vërtetë qytetarët po i respektojnë masat dhe sa po frekuentojnë dhe po krijojnë turma.
- Ka pasur lajmërimë nga inspektorati i tregut që ka problem me aplikimin e masave dhe udhëzimeve nga Ministria e Shëndetësisë dhe ky sinjal shqetësues mund të rezultojë që MEPTINIS t'i drejtohet MSH-së që të marrin masa shtesë për bizneset. Qëllimi i këtyre veprimeve do të ishte të shpëtohen sa më shumë jetë, por edhe të mbrohet ekonomia sepse nëse del situata nga kontrolli, nuk do të kemi arsye që të ruhet ekonomia.
- Sa i përket grupeve për pakon e rimëkëmbjes Ministria Hajdari sqaroi se një gjë e tillë është në rregull që brenda këtij grupi koordinues që është në nivel nacional, të jetë edhe grupi teknik punues, por edhe grupet tjera. U deklarua edhe hapsira për propozime për të krijuar edhe grupe tjera shtesë, për të sjellur alternativat për rimëkëmbje ekonomike.

**Berat Rukiqi, Kryetar në Odën Ekonomike të Kosovës (OEK)** plotësoi komentimin paraprak të tij duke sqaruar se nuk po kërkohet shpëputje e masave, mirëpo vazhdim me respektimin e tyre nga ana Bizneseve dhe mbikqyrje më e lartë nga policia apo organet e rendit drejtë turma të qytetarëve.

- Për qendrat tregtare, ai bëri me dije se e kishte fjalën për qendrat e hapura tregtare.
- Për sa i përket grupit, ai tha se nuk ka kuptim të mos konsultohet OEK si Odë nacionale në çfarëdo grupi, iniciative, ligji dhe strategjie. Mbështeti këtë me argumentin se brenda OEK janë 30 shoqata, gjysma e tyre merren me prodhim, ndërsa pjesa tjetër merret me ndërtim, tregti dhe të

gjithë sektorët e ekonomisë. Sipas tij, Qeveria ka për obligim të konsultoj OEK-un për secilen pako, iniciativë, ligj dhe strategji, duke pasur parasysh që OEK është themeluar në bazë të ligjit të miratuar nga Kuvendi Kosovës.

**Rozeta Hajdari, Ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë, dhe Investimeve Strategjike** tha se mundësia rotacionit, e përmenduar nga Zëvendësministri Aliu, mund të jetë një zgjidhje dhe shoqata, përfaqësuese të industrisë si ajo e drurit, që ka një potencial të zhvillimit ekonomik apo nga industritë që propozon Oda varësisht prioriteteve. Kjo qasje duket shumë konstruktive dhe mbetet të shqyrtohet më tutje me Ministrinë e Financave dhe Transfereve për të arritur në një konkludim. Ajo theksoi se në këtë Grup Koordinues janë të përfshirë gjithë dhe bëri apel që të drejtojnë infuzionet financiare ekonomike, kurse Grupi teknik i cili për qëllim të jetë një grup i vogël apo grup fokusi, që të mundohet të adresoj çështjet e industrisë, eksportit, tregtisë me pakicë.

**Yllka Metaj, Drejtoreshë e Rrjetit të Shitësve me Pakicë (RRSHP)** shpalosi propozimin nga shoqata që përfaqëson si në vijim vijim:

- Likuiditeti – duke marrë parasysh që bankat në Kosovë operojnë me 3.3 miliard Euro, një pjesë e madhe nuk është duke u shfrytëzuar, RRSHP sugjeron që Qeveria e Kosovës bashkë me Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) dhe Bankën Qëndrore të Kosovës (BQK) të realizojnë marrëveshje ku 20% e kësaj shume të shpërndahet si kredi ndaj bizneseve të vogla dhe të mesme me afat kthimi 30 muaj, ku 6 muaj të jenë “grace periudhë” me interes minimal. Kjo të varet nga arritja e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë, BQK-së dhe bankave komerciale. Qeveria e Kosovës përmes FKGK të jetë garantues ndaj institucioneve bankare. Sipas parashikimeve, Thesarit të Kosovës, kjo mund të kushtoj rreth 25-35 milion Euro, varësisht nga interesi i cili aplikohet. Në lidhje me atë se si mund të ndahet dhe realizohet kjo shumë tek NVM-të, RRSHP propozon të mirret për bazë vlera totale e realizimit në vitin 2019. Pra nëse mirret shuma 600-700 milion Euro dhe përpjestohet me p.sh. 3 miliard Euro nga realizimi i bizneseve, atëherë del rreth 22% i realizimit vjetor gjatë vitit 2019, që mund të jetë shuma maksimale e marrjes së kredisë nga ana e një biznesi. Sipas kësaj, nëse një biznes ka qarkullim 1 milion Euro, atëherë shuma maksimale e kredisë do ishte 220,000 Euro. Marrëveshja ndërmjet institucioneve shtetërore dhe NVM-ve për kthimin e kredive mund të arrihet në atë mënyrë që Qeveria e Kosovës përmes aplikacioneve të bizneseve të informoj FKGK, BQK-në dhe bankat komerciale për të dërguar ato aplikacione të cilat janë miratuar dhe në bazë të këtyre aplikacioneve të bëhet transferimi i vlerave tek NVM-të, sipas aplikimeve në sistemin EDI. Kredia e lëshuar të ketë 0 kamat ndaj NVM-ve. Afati i kthimit të jetë 24 muaj duke filluar nga janari i vitit 2021. Prej datës 1 - 15 qershor të bëhet transferi i kredive ndaj bizneseve dhe ndërkohë 6 muaj, bizneset ta shfrytëzojnë për stabilizim dhe rimëkëmbje, në mënyrë që në janar 2021 të mund të fillohet me kthimin e kredisë në baza mujore. Për 6 muajt e parë nga 1 qershor 2020, biznesi mos të paguajë kamat, mirëpo nëse biznesi do ketë vonesa në kthim të kredisë, atëherë të aplikohet ndërshkimi që do ishte i barabartë me interesin që bankat komerciale kanë ofruar ndaj institucioneve shtetërore.
- Sa i përket përfshirjes së përfaqësuesve të biznesit në grupin e themeluar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, znj. Metaj tha se ajo është për përfshirjen e odave nacionale, por në anën tjetër eksperiencia me AmCham për një kohë që tashmë është në RRSHP, nuk ka rezultuar që të jetë shumë bashkëpunuese. Megjithatë, beson që secili që do jetë në grup do kryej punë të frytshme.

**Ilir Aliu, Zëvendësministër i Ministrisë të Financave dhe Transfereve** sqaroi se MFT nuk është diskriminues ndaj asnjëres Odë, dhe se në pakon e parë janë takuar me secilën prej odave të cilat i ka pyetur për

problemet e bizneseve, të gjitha ato që odat kanë rekomanduar në MFT janë adresuar, më shumë jo, mirëpo si problem po aq sa i kanë pasur mundësit si MFT. Zëvendësministri i ftoi të gjithë të kontribuojnë aq sa mundën dhe tha se do të marrin në konsideratë secilën kërkesë. Sipas informatave që ai ka, tha se Klubi i Prodhuesve është nën ombrellën e OEK-së ose është e pavarur, mirëpo paraqet një sektor të bizneseve të Kosovës dhe mundësinë për të kontribuar e kanë të gjithë.

**Ibrahim Xhaka, ushtrues detyre i Drejtorit të Doganës së Kosovës** dha disa sqarime specifike në lidhje me punën e Doganës në këtë kohë. Ai tha se:

- Sa i përket korridorit të gjelbërt për eksport ata kanë bërë përpjekje jo vetë Brenda Doganës së Kosovës por edhe marrëveshje ndërkombëtare. Edhe me Bashkimin Evropian është alarmuar situata, sepse fillimisht kishin pasur vështirësi, sidomos për eksport. Po ashtu është treguar kujdes për eksportin e produkteve mjekësore dhe paisjeve tjera të përcaktuara me ligj. Përveç bashkëpunimit ndërinstitucional, Doganat kanë bashkëpunuar me të gjitha odat në Kosovë.
- Lidhur me lirimimin e lëndës parë, kompanitë prodhuese dhe ato që eksportojnë janë fokusi kryesorë i Doganave. Kohë pas kohe ato kanë paraqitur disa kërkesa për lirimimin e lëndës së parë, të cilat kanë mundur të trajtohen si lëndë e parë por edhe si produkt final. Gjithashtu, z. Xhaka theksoi se kanë pasur kërkesa nga OAK të cilat i janë zgjidhur, lidhur me lëndën e parë. Po ashtu ai tha se janë takuar me OEK edhe për shtyerjen e obligimeve për të cilat subjektet kanë autorizim nga Dogana e Kosovës, përkatësisht për taksat e pezulluara si pasojë e pandemisë.

**Lumnije Ajdini, Aleanca Kosovare për Biznes (AKB)** vazhdoi me shpalosjen e disa pikave nga ana e AKB-së.

- AKB ka identifikuar strukturën e eksporteve dhe cilët sektor janë potencial me eksport, në bazë të hulumtimit me UNDP-në del sektori i përpunimit të drurit, ushqimit, IT-së.
- Në lidhje me këtë Grup Koordinues znj. Ajdini nuk mbështet se duhet folur për TVSH, 3 projektligjet si ai për ATK-në, TVSH-në dhe për të ardhurat personale tha se do të ndryshohen në Kuvendin e Kosovës, të gjitha këto ligje janë në kuvend dhe duhet të miratohen. Prandaj sipas znj. Ajdini, nuk duhet të kërkohet nga Qeveria ndryshimi i këtyre ligjeve në këtë kohë.
- Në lidhje me BQK, znj. Ajdini kritioi se ky institucion ndryshe ka interpretuar vendimin për shtyerjen e kredive dhe ndryshe kanë operuar bankat komerciale.
- Për likuditet ajo tha: “flasim për bizneset që kanë kredi mbi 1 milion Euro. BQK të kërkoj shtyerjen e interesit për tre muaj nga ana e bankave komerciale”.
- Në fund parashtrroi kërkesën për rritjen e numrit të inspektorëve.

**Ilir Murtezaj, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK)** ndau disa informata rreth realizimit të atyre pikave të Pakos Emergjente për të cilat ATK është autorizuar që t'i implementoj.

- Z. Murtezaj tha se deri më tani është punuar mbi kërkesat nga bizneset për mbulimin e pagave të mbi 150,000 të punësuarve, prej tyre rreth 130,000 të kategorisë A (punëtor aktiv), 1,293 të kategorisë B (që kanë shkëputur kontratat), 1,118 të kategorisë C (kanë lidhur kontrata të reja të punës – pas datës 1 mars 2020) dhe 8,724 të kategorisë që janë në rrëzikshmëri, që nënkupton punëtorët në markete, barnatore, furra buke. Pra, totali është 148, 536 sipas të dhënave nga ora 10:00 (5 maj 2020).
- Në lidhje me temën e dytë Drejtori Murtezaj tha se një gjë që nuk u diskutua, përveq nga z.Zeka, ishte çështja e interesit i cili kalkulohet ndaj tatimpaguesëve të cilët nuk arrijnë t'i paguajnë obligimet tatimore me kohë. Ai përmendi se në takimin e veçantë që ka pasur me Ministrin Bislimi dhe disa përfaqësues të odave është diskutuar kjo dhe është konfirmuar se kjo kategori do të mund të rregullohet vetëm me ligj të veçantë në Kuvend dhe as ATK dhe as MFT nuk e kanë autoritet të marrin masa. Pra, do të ishte mirë që të bëhej një zgjidhje në këtë drejtim.

Ai shtoi se ATK është duke punuar që kërkesat për marrveshje për pagesë të zhvillohen përmes platformës EDI. Kjo do parandalonte vizitat fizike në ATK dhe i gjithë komunikimi do të zhvillohej në mënyrë elektronike deri tek nënshkrimi i marrëveshjes.

**Rozeta Hajdari, Ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike** u shpreh mirënjohëse që të gjithë ishin konstruktiv në këtë takim frytdhënës, duke shtuar se ata nuk do të mbesim vetëm me këtë takim, por edhe më shumë të tjera në vijim. Ministrja Hajdari tha se shpreson që u qartësuan se ka një paralelizëm apo duplikim dhe se gjithmonë, ky sektor janë forca kryesore në këtë platformë dhe japin orientimin dhe potencialin kryesor për zhvillim ekonomik. Në fund Ministrja Hajdari i inkurajoi që të gjitha pikat që u shpalosën në takim të dërgohen dhe përmes e-mailit.